

Shtatë gjërat që sjellin dashurinë ndaj Zotit

Një: Njohja e begatave të All-llahut [subhanehu ve tealja] që Ai i ka vendosur mbi robërit e Tij. Këto begati (jane aq të shumta) sa nuk mund të numërohen apo të llogariten. All-llahu [subhanehu ve tealja] thotë: **"Nëse ju i numëroni begatitë e All-llahut ju nuk do të jeni te aftë t'i numëroni ato."** [14:34]

Zemrat natyrisht kanë dashuri për ata që bëjnë mirë atyre vet. Dashuria për begatitë është nga aspektet e përgjithshme të falënderimit për dikënd i cili ka vendosur një begati. Është thënë që falënderimi është në zemër, gjuhë dhe gjymtyrë.

Dy: Dija për All-llahun [subhanehu ve tealja], emrat e Tij, Atributet e Tij dhe Veprat e Tij. Njeriu që e njeh All-llahun [subhanehu ve tealja] e don Ate.

Kushdo që e do Ate i bindet Atij. Kushdo që i bindet All-llahut [subhanehu ve tealja] është i nderuar nga Ai. Kushdo që është i nderuar nga All-llahu [subhanehu ve tealja], Ai do ta mbajë atë afër Tij. Kushdo që mbahet prej Tij ka mirëpritur shpërblimin e këndshëm.

Tre: Dituria e veçantë që vjen nga meditimi mbi krijimin e qiejve dhe tokës dhe atë që All-llahu [subhanehu ve tealja] e ka krijuar.

Në Kur'an gjenden shumë përmendje të shenjave të All-llahut [subhanehu ve tealja] që tregojnë Madhësinë, Fuqinë, Madherinë, Perfeksionin, Shkëlqesinë, Meshirën... e Tij dhe emrat e Tij të bukur gjithashtu Atributet e madhëruara.

Kur dituria e dikujt për All-llahun [subhanehu ve tealja] është e fuqishme dashuria për Të është gjithashtu e fuqishme dhe dashuria për t'u bindur Atij është gjithash-

Njerëz me ambicje të larta

Nxënës i nderuar!
Kush të pengon nga epërsia dhe sukseset?
A është varfëria? Ose Sëmundja? Ose dembelia dhe përtacia?

Lërë përtacinë dhe nisu drejt lartësive.
Ja një shembull në këtë drejtim:
Dr. Muhamed Jahja është profesor i letërsisë angleze në fakultetin filologjik në universitetin e Kairos dhe është shembull në këtë drejtim.

Ai vuan nga sëmundja e muskujve që nga klasa e parë, pasi që kishte pasur temperaturë të lartë. Shërimi nuk korri sukses dhe sëmundja ia dëmtoj të gjitha muskujt, kurse kjo shkaktoi mosfunktionalitet të tërë trupit të tij, përveç një lëvizjes së vogël të dorës, si nderim nga Zoti, me te shkruan dhe i udhëheqë disa punë të tija.

Babai i tij e dërgonte dhe merte nga shkolla. Kështu veprroi derisa u regjistrua në Fakultetin e Filologjisë, në të cilin fakulteti ishte i pari gjatë tërë viteve të studimeve. U mahnit me te profesori i tij, dr. Reshad Rashidi dhe vendosi të sfidon rregullat e universitetit dhe e përcaktoi si asistent në katedrën e tij. Ai vazhdoi studimet e tija të larta gjersa u bë profesor doktor në Universite, përkthyes, mendimtar, analist, shkrimtar islamik, i cili ka disa libra të botuara dhe kontribute të dalluara në gazeta dhe revista arabe.

Dhjetë gjëra që nuk të sjellin dobi

Dhjetë gjëra janë të humbura dhe nuk të sjellin dobi:

-Dituria me të cilën nuk vepron.

-Vepra pa sinqeritet dhe dhe e shpikura në fe.

-Pasuria që nuk shpenzohet.
Pronari saj as që kënaqet me të në botë e as që e dërgon para vete në ahiret.

-Zemra e zbrastë nga dashuria ndaj All-llahut [subhanehu ve tealja], e cila nuk mallëngjohet për All-llahun [subhanehu ve tealja] dhe afërsinë e Tij.

-Trupi i cili nuk i nënshtrohet All-llahut [subhanehu ve tealja] duke e shërbyer Ate [subhanehu ve tealja].

-Dashuria (ndaj All-llahut) e proklamuar e cila nuk vërtetohet me zbatim të urdhërave të Tij.

-Koha e humbur pa përfutur mirësi dhe vepër që të afron tek All-llahu [subhanehu ve tealja].

-Mendja e cila lodhet duke menduar për gjëra pa vlerë.

-Shërbimi i atij që nuk të afron tek All-llahu [subhanehu ve tealja] e as që përfiton nga ai në këtë botë.

Diçka për të menduar...

-Çudi si një banknotë duket aq e madhe kur e japim në xhami, kurse aq e vogël kur e japim në pazar.

-Çudi sa të gjata janë dy orë të kaluara në xhami, e sa të shkurtëra janë kur shohim ndonjë film.

-Çudi si nuk mund të kujtohem të themi asgjë kur lutemi, kurse aspak nuk kemi vështirësi për të menduar gjëra që duhet t'i themi shokut.

-Çudi si gëzohemi kur loja e futbollit zgjatet për disa minuta, kurse ankohe mi kur "Teravija" gjatë Ramazanit është më e gjatë se zakonisht.

-Çudi sa rëndë është për të lexuar një ajet në Kur'an, kurse sa lehtë është të lexohen 100 faqe të ndonjë novela (letrare, artistike).

-Çudi si njerëzit duan të ulen në ulëset e para në ndonjë lojë apo koncert, kurse shtyhen të mbeten në rreshtat e fundit në xhami, me qëllim që të largohen sa më shpejt.

-Çudi si na nevojiten 2 deri në 3 javë para kohe të na tregohet për ndonjë ndodhi në xhami që ta fusim në orarin tonë, kurse për ndodhitë tjera e ndërrojmë orarin pa vështirësi edhe në

Detyrat e mia personale në jetë

Në vend se të jetojmë nën shpresa dhe parafytyrimet imagjinare, më mirë është që të përcaktojmë detyrat dhe shpresat tona në jetë, t'i shkruajmë me dorën tonë dhe t'i vëdojmë para tavolinës së punës, që t'i shohim për çdo ditë dhe që përherë në bazë të saj të llogarisim vetveten.

- 1- Çdo herë nxitoj ta kënaqi All-llahun [subhanehu ve tealja].
- 2- Vazhdimisht e përkujtoj sinqeritetin.
- 3- Do ta mësoi përmendsh tërë Librin e All-llahut [subhanehu ve tealja].
- 4- E shtoj dijen time fetare.
- 5- Kujdesem për përmirësimin e zemrës dhe shërimin e saj.
- 6- I zhvilloj mundësitë e mia fizike.
- 7- I zhvilloj mundësitë e mia emocionale.
- 8- Shkoj në xhami para ezanit.
- 9- Jap sadaka për çdo ditë.
- 10- Çdo gjë që shpenzoj për familjen time, llogaris në shpërblimin e saj.
- 11- Për çdo vepër time shpresoj të shpërblehem për te.
- 12- Fillimisht arrij sukses në shtëpimë time.
- 13- Nuk bëj koncesione në fenë time.
- 14- Konsultohem me të tjerët.
- 15- I mbroj ata që nuk janë të pranishëm.
- 16- I dëgjoj që të dyja palët para se të gjykoj.
- 17- Futem nën lekurën e bashkëbiseduesit tim dhe partitipoj në ndjenjat e tija.
- 18- Nuk hakmirem për vetveten.
- 19- Nuk hidhërohem për vetvete.
- 20- Nuk shoh se kam të drejta mbi të tjerët.
- 21- Çdo herë do të jem pozitiv.
- 22- Planifikoj sot për punën e të nesërmes.
- 23- Më shumë dëgjoj se sa flas.
- 24- Dëshiroj që të arrijnë sukses të tjerët.

Të fitoni dashurinë e All-llahut [subhanehu ve tealja]

Motra ime e dashur, a je ti prej atyre të cilat gypin e ujës-jellësit e lënë të hapur deri në fund, nga i cili rrjedh ujë pa ndërprerë, deri sa ti je e zënë me bisedën tënde telefonike me fqinjën apo shoqen tënde? A je ti prej atyre që i harrojnë gjërat të hapura dhe të cilat dëmtojnë shtëpinë dhe orënditë shtëpiake? A je ti prej atyre, që të gjitha llambet elektrike i ke të ndezura kur je jashtë shtëpisë, apo kur asnjë njeri nuk është mbrenda në shtëpi?

Nëse je prej atyre... atëherë frikohem se je prej atyre të cilat kanë humbur dashurinë e All-llahut [subhanehu ve tealja].

"O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje), hani e pini e mos e teproni, pse Ai (All-llahu) nuk i do ata që e teprojnë (shkapërdherhin)." (El-A'rafë: 31).

Imam Er-Raziu [radjiall-llahu anhu] thotë: "Ky është fundi i kërcënimit, ngase çdo njeri të cilin All-llahu [subhanehu ve tealja] nuk e do, mbetet i mënjeluar nga shpërblimi i Tij, sepse dashuria e All-llahut [subhanehu ve tealja] nënkupton të shpërbyerit e robit me shpërblime, e humbja e kësaj dashurie nënkupton, mënjanimin e robit nga ky shpërblim. Kur rob i nuk e arrin shpërblimin, atëherë pa dyshim e gjen dënimin, sepse të gjithë dijetarët janë të një mendimi se nuk ekziston dot njeri që është i obliguar me normat fetare (mukel-lef), e të mos shpërblehet apo dënohet." (Et-Tefsir El-Kebir 14/62)

Edhe ti motra ime, në qoftë se bëhesh prej atyre që e teprojnë (shkapërdherhin) pasurinë e tyre, do të humbësh dashurinë e All-llahut [subhanehu ve tealja], e kur ta humbësh atë, ti do të bëhesh (do të jesh) përgjegjëse e vetme për dënimin e Tij, pasi të bëhesh e mënjeluar nga shpërblimi i tij.

Transmeton Abdullah bin Omeri [radjiall-llahu anhu] se: "Një ditë kaloi i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-

-Frika yte dhe mbështetja tek ai i cili është nën sundimin e All-llahut, i cili nuk mund t'i sjell vetes as dobi e as dëm. Nën sundimin e tij nuk është as jeta e tij vdekja e tij dhe ringjallja e tij.

A e dini **cila është humbja më e madhe,** humbja e cila është esencë e çdo humbjes: **Ajo është humbja e zemrës dhe humbja e kohës.**

E ka humbur zemrën ai i cili i ka dhënë përparësi kësaj jete para ahiretit dhe nuk e humb kohën përpos njeriut të cilin e ka mashtruar shpresa për jetë të gjatë.

Është i **prishur** në esencë ai tek cili tubohen dy gjëra **pasimi i epshit dhe shpresa për jetë** të gjatë dhe ka shpëtuar ai qëpason udhëzimin dhe përgaditet për ditën e takimit (Kijametin). All-llahun e lusim që të na ndihmon.

Shkëputur nga libri "El Fevaid" të Ibën Kajjimit fq.384-385.
Me redakturë të Ali Hasen El Halebij Solli në shqip: Talha Kurtishi

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 32 23-654
1000, Shkup



Dr. Muhamed Jahja thotë: arrita ta vazhdoj shkollimin tim me durim dhe qëndresë. I kam mësuar pesë gjuhë: gjuhën angleze, franceze, gjermane, italiane dhe spanjolle. Tani jam mentor i disertacioneve të magjistraturës dhe doktoraturave në katedrën e gjuhës angleze, përkthej librat bazorë dhe nuk kam aspak kohë të lirë. Elhamedullillah, jam martuar dhe kam një djalë dhe një vajzë.

Dr. Muhamed shton dhe thotë: e meta fizike shume herë krijon stimulimin te njeriu për ta kompenzuar atë, që më vonë të tregon sukses dhe epërsi në shumë sfera të jetës.

All-llahu, subhanehu ve tealja, ndoshta e privon njeriun e hendikepuar nga ndonjë gjë, mirëpo ia kompenzon me gjëra tjera, e bën largpamës, intelgjentë, me kujtesë të fuqishme, me qëndresë, aktiv, dashamir i punës, me shpirt lideri dhe i tërëhjekshëm për njerëzit.

I zellshëm është ai që ka mundësi ti një aftësitë dhe shkathtësitë e tija dhe ka mundësi ti punësojë dhe ti shfrytëzojë si duhet. Kjo vlen për njeriun e hendikepuar, e çka të themi për ate që All-llahu e ka krijuar me shëndet të plotë dhe pa të meta fizike?!

Marrë nga: islamtoday.net
Përktheu: Bekir Halimi

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 32 23-654
1000, Shkup



tu e fuqishme.

Katër: Mundi i të vepuarit drejt All-llahut [subhanehu ve tealja], me sineritet dhe pastërti duke shkuar kundër dëshirave personale. Kjo është një punë që bëhet shkak që All-llahu [subhanehu ve tealja] ta begatojë një rob dhe kur Ai begaton robin, robi e don Ate.

Pesë: Shtimi i përmendjes së All-llahut [subhanehu ve tealja] (dhikrit). Kur një person don dikend ai e kujton ate më shpesh. Dhe përmes përkujtimit të All-llahut [subhanehu ve tealja] zemrat e njerëzve qetësohen. Edhe njëra nga shenjat e të pasurit dashuri për All-llahun është përkujtimi i All-llahut, nga zemra dhe gjuha e personit.

Gjashtë: Recitimi i shpeshtë i Kur'anit dhe meditimi për kuptimin e tij, e në veçanti për ato ajete që përbajnë emrat, atributet dhe veprat e All-llahut [subhanehu ve tealja]. Për dashurinë ndaj kësaj veprë All-llahu [subhanehu ve tealja] do ta udhëzojë robin ta dojë All-llahun [subhanehu ve tealja] dhe All-llahu ta dojë ate.

Shtatë: Përkujtimi i asaj që është përmendur në Kur'an dhe në sunnetin e Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve selem] duke i premtuar besimtarëve se do ta shohin Zotin e tyre në Xhennet dhe takimin me Te në ditën e Bollëkut. Gjë që do sjellë definitivisht tek personi dashurinë për All-llahun [subhanehu ve tealja].

Imam Rexhep Ibën Hanbeli
Përktheu: Ammar Ardit Kraja

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 32 23-654
1000, Shkup



lem] pranë Sa'dit i cili ishte duke marrë abdest dhe i tha: "O Sa'd, ç'është kjo tepricë (derdhje e ujit pa nevojë)?".

Sa'di tha: "O i Dërguari i All-llahut, a edhe në abdest ka tepricë (shkapërdërdhje)?".

I Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: "Po, edhe në qoftë se je pranë një lumi që rrjedh". (Ibën Maxhe dhe Tirmidhi hadithi është i dobët)

Sa'di [radijall-llahu anhu] mbeti i habitur nga fjalët të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] se nuk lejohet të tepruarit në harxhimin e ujit gjatë abdestit. Ai kishte menduar se një gjë e tillë nuk mundet të jetë tepricë (israf), pasi që abdesti është ibadet. Mirëpo i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e vërtetoi atë, duke e bërë edhe më të qartë, kur sqaroi se bollëku i ujit nuk e mohan nevojën për kujdes prej israfit, duke i thënë: "Po, edhe në qoftë se je pranë një lumi që rrjedh".

Edhe pse uji i lumit është i bollëshëm dhe se njeriu i cili merr abdest asnjëherë nuk do të mundë që të pakon diç nga uji i tij, prapëseprap, edukata e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe udhëzimi i tij që që njeriu të jetë i matur në çdo gjë, dhe matura e tij të jetë cilësi e përhershme e tij, kudo që të jetë dhe në çfarë do gjendje të jetë.

Motra ime e dashur, ki kujdes në maturi dhe largohu nga çdo gjë që të shpie në shkapërdërdhje (israf), në ujë, rrymë si dhe në gjëra tjera, që të arrih të fitosh dashurinë e All-llahut të Lartëmadhëruar dhe shpërblimin e Tij. Kështu All-llahu [subhanehu ve tealja] do t'i vazhdojë begatitë e tija ndaj teje, po bile edhe do t'i shtojë, se Ai i Lartëmadhëruari është më i miri nga i cili kërkohet dhe më i miri i cili përgjigjet.

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 32 23-654
1000, Shkup



25- I iki me sa mundem gabimit dhe përfitojë nga ai kur të bijë në te.

26- Mendohem që të jem i rregulluar dhe i organizuar në vetvete dhe në punën time.

27- Kujdesem që të jem gazmor, i buzqeshur dhe i lehtë.

28- I koncentroj të gjitha mundësitë dhe përpjekjet mbi detyrën që e kam përpara.

29- I zhvilloj shkathtësitë e mia.

30- Kujdesem për prioritetet në të gjitha aktivitetet e mia.

31- Nuk e humbi atë që kam marrur në përgjegjësi dhe nuk marr në përgjegjësi atë që nuk kam nevojë.

32- Nuk i qortoj situatat dhe gjendjet.

33- Kujdesem për atë që më intereson dhe koncentrohem në qarkun e ndikimit tim.

34- Gjuha ime është: mendohem, përipiqem, provoj, mësoj, nuk është e pamundshme, çka është pengesa.

35- E dijë se ajo që më ka qëlluar nuk ka pasur të më gabojë dhe se ajo që më ka gabuar nuk ka pasur të më qëllojë.

36- E dijë se ajo që më ka goditur është prej shpirtit tim dhe nga ajo që e kam fituar. Vazhdoj llogarinë e vetvetes dhe jam i çelur me shpirtin tim. Prej besimit në vetvete është kthimi nga gabimi, andaj punoj që ta përmirësoj gabimin.

37- Nuk e parafytyroj se ndokush mundet të shpëton prej njerëzve, andaj e kursej kohën nga preokupimi im me ta dhe përgjellja e fjalëve të tyre. Prej fjalëve të tyre nuk më intereson asgjë tjetër përveç asaj që më ndihmon në përmirësimin e të metave të mia.

Dr. Jahja Ibrahim el-Jahja
Përktheu: Bekir Halimi

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 32 23-654
1000, Shkup



momentin e fundit.

-Çudi sa rëndë është për njerëzit të mësojnë një ligjeratë aq mirë sa për t'ua treguar të tjerëve, kurse sa lehtë ju vjen t'i kuptojnë dhe t'i përsërisin thashethemet.

-Çudi si besojmë atë që e shkruajnë gazetat, kurse dyshojmë në atë që e thotë Kur'ani.

-Çudi si secili dëshiron të shkojë në xhennet, deri sa nuk besojnë, ose nuk mendojnë, ose thuan, ose bëjnë diçka.

-Çudi si mund të dërgoni njëmijë "shaka" me anë të e-mailit dhe ato shpërndahen si zjarr i egër, kurse kur filoni të dërgoni mesazhe në lidhje me All-llahun [subhanehu ve tealja], njerëzit mendojnë dy herë për ta ndarë këtë me dikend tjetër.

ÇUDI APO JO?!

A jeni duke qeshur?!

A jeni duke menduar?!

Shpërndajeni Fjalën dhe falënderojuni All-llahut [subhanehu ve tealja], sepse Ai është i Mirë dhe i Mëshirshëm!

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 32 23-654
1000, Shkup

